

EDMOND ÇALI

**GJUHA E VEPRAVE TË PABOTUARA TË KASËM
TREBESHINËS DHE STANDARDI: ROMANI *DAFINA TË THARA***

1.a. Dafina të thara

Në këtë punim prezantoj romanin *Dafina të thara* të Kasëm Trebeshinës, versionin që më ka dhënë autori dhe që e kam përkthyer nga shqipja në italishte dhe që e kam botuar në Itali në vitin 2007. Shqyrtoj marrëdhëniet e gjuhës së romanit me normën e drejtshkrimit të vitit 1972. U kushtoj rëndësi të gjitha ndryshimeve nga norma. Më rezulton se edhe gjuha e kësaj vepre dëshmon qëndrimin idiosinkratik të Kasëm Trebeshinës ndaj letrave shqiptare. Teksti në gjuhën shqipe i librit *Dafina të thara, romani i jetës sime* është një material i shkruar me makinë shkrimi: janë 165 faqe A4, të pajisura me numër rendor. Në kapak është titulli: “Dafina të thara”. Vijon një përcaktim: *romani i jetës sime*. Emri i autorit është Kasëm Trebeshina – Vinokashi. Data e shkrimit jepet edhe në kapak edhe në faqen e fundit: 1988. Pjesa e parë titullohet “Djali nga Vinokashi” dhe shkon nga f. 1 deri në f. 84. Pjesa e dytë “Errësira e shekujve” shkon nga f. 86 deri në f. 165. Pjesa e parë ka 23 kapituj të pajisur me numër rendor dhe me titull. Pjesa e dytë ka 21 kapituj të pajisur me numër rendor dhe me titull.

1.b. Dafina të thara – pjesa e parë

Faqja e parë e pjesës së parë ku gjendet edhe titulli (Pjesa e parë: DJALI NGA VINOKASHI) nuk ka numër faqeje dhe nuk përfshihet në numërimin e faqeve të të gjithë materialit.

Kapitulli i parë titullohet “Plagë dhe lule” dhe zë faqen 1, faqen 2, faqen 3 dhe faqen 4. Në fillim të çdo kapitulli kemi numrin e kapitullit (KAPITULLI I PARË) dhe pastaj në rreshtin që vijon titullin e kapitullit.

Kapitulli i dytë, që titullohet “Ardhja e ime në jetë”, zë faqen 5, faqen 6, faqen 7 dhe pothuajse gjithë faqen 8.

Kapitulli i tretë, që titullohet “Turbullirat familjare”, fillon në faqen 8, ku kemi vetëm tre rreshta të këtij kapitulli dhe zë faqet 9, 10, 11 dhe mbaron në fillim të faqes 12, ku ka vetëm gjashtë rreshta.

Kapitulli i katërt, që titullohet “Zonja e mëshirëshme”, fillon në faqen 12, vijon në faqen 13, 14 dhe mbaron në faqen 15, ku ka vetëm një rresht.

Kapitulli i pestë, që titullohet “Magjepsja e gjermave”, fillon në faqen 15, vazhdon në faqen 16 dhe mbaron në faqen 17, ku zë pothuajse të gjithë faqen.

Kapitulli i gjashtë titullohet “Komitët”. Fillon në fund të faqes 17, ku kemi vetëm rreshtin e parë, dhe zë faqet 18, 19, 20, 21 dhe 22.

Kapitulli i shtatë, që titullohet “Një histori dashurie”, zë faqet 23, 24 dhe mbaron në faqen 25, ku kemi dy rreshtat e fundit të kapitullit.

Kapitulli i tetë, që titullohet “Mësuesit e mi të parë”, fillon në faqen 25 dhe mbaron në fund të faqes 28.

Kapitulli i nëntë, që titullohet “Fantazma”, fillon në faqen 29 dhe mbaron në mes të faqes 32.

Kapitulli i dhjetë, që titullohet “Komunistët”, fillon në faqen 32 dhe mbaron në fund të faqes 35.

Kapitulli i njëmbëdhjetë, që titullohet “Pushtimi i Shqipërisë”, zë faqet 35-38.

Kapitulli i dymbëdhjetë, që titullohet “Udhëheqësit komunistë”, fillon në faqen 38 dhe mbaron në faqen 42.

Kapitulli i trembëdhjetë, që titullohet “Besimi i im në fenë e re”, fillon në faqen 42 dhe mbaron në faqen 43.

Kapitulli i katërbëdhjetë, që titullohet “Pazarllëku tragjik”, fillon në faqen 43 dhe mbaron në faqen 46.

Kapitulli i pesëmbëdhjetë, që titullohet “Unë marr kontakt me armikun” fillon në faqen 46 dhe mbaron në faqen 50.

Kapitulli i gjashtëmbëdhjetë, që titullohet “Prapa hekurave të burgut”, fillon në faqen 50 dhe mbaron në faqen 52.

Kapitulli i shtatëmbëdhjetë, që titullohet “Dy dështime”, fillon në faqen 52 dhe mbaron në faqen 56.

Kapitulli i tetëmbëdhjetë, që titullohet “Bëhem anëtar partie”, fillon në faqen 56 dhe mbaron në faqen 59.

Kapitulli i nëntëmbëdhjetë, që titullohet “Banditë dhe ushtarë”, fillon në faqen 59 dhe mbaron në faqen 64.

Kapitulli i njëzetë, që titullohet “Të përpjetat dhe të tatëpjetat në Vjeshtë”, fillon në faqen 65 dhe mbaron në faqen 69.

Kapitulli i njëzetënjëtë, që titullohet “Një dimër i egër”, fillon në faqen 69 dhe mbaron në faqen 75.

Kapitulli i njëzetedytë, që titullohet “Vallja e Vitit të Vjetër dhe ajo e Vitit të Ri”, fillon në faqen 75 dhe mbaron në faqen 80.

Kapitulli i njëzetetretë, që titullohet “Kthimi i im në politikë”, fillon në faqen 81 dhe mbaron në faqen 84.

1.c. Dafina të thara – Pjesa e dytë

Pjesa e dytë e librit, që titullohet “Errësira e shekujve” ka njëzet e një kapituj. Fillon në faqen 85 dhe mbaron në faqen 165.

Kapitulli i parë i pjesës së dytë, që titullohet “Hardhucat në diell”, fillon në faqen 86 dhe mbaron në faqen 91.

Kapitulli i dytë, që titullohet “Rrebelimi”, fillon në faqen 91 dhe mbaron në faqen 96.

Kapitulli i tretë, që titullohet “Rruga e gjatë”, fillon në faqen 96 dhe mbaron në faqen 100.

Kapitulli i katërt, që titullohet “Ata ndërrojnë temë”, fillon në faqen 100 dhe mbaron në faqen 104.

Kapitulli i pestë, që titullohet “Kartografi më i mirë në botë”, fillon në faqen 104 dhe mbaron në faqen 107.

Kapitulli i gjashtë, që titullohet “Deti dhe Britanikët”, fillon në faqen 107 dhe mbaron në faqen 112.

Kapitulli i shtatë, që titullohet “Unë ushtroj autoritetin tim”, fillon në faqen 113 dhe mbaron në faqen 117.

Kapitulli i tetë, që titullohet “Ne bëhemi përsëri miq”, fillon në faqen 117 dhe mbaron në faqen 119.

Kapitulli i nëntë, që titullohet “Shqiptarët zbresin në fushën e luftës”, fillon në faqen 120 dhe mbaron në faqen 124.

Kapitulli i dhjetë, që titullohet “Unë dorëzoj armët”, fillon në fundin e faqes 124, ku ka vetëm një rresht dhe mbaron në faqen 129.

Kapitulli i njëmbëdhjetë, që titullohet “Kënga e ime e fundit në luftë”, fillon në faqen 129 dhe mbaron në faqen 133.

Kapitulli i dymbëdhjetë, që titullohet “Miladin Popoviçi, unë dhe përrallat”, fillon në faqen 133 dhe mbaron në faqen 137.

Kapitulli i trembëdhjetë, që titullohet “London – Paris”, fillon në faqen 137 dhe mbaron në faqen 141.

Kapitulli i katërmëdhjetë, që titullohet “Enver Hoxha si lojtar”, fillon në faqen 142 dhe mbaron në faqen 144.

Kapitulli i pesëmbëdhjetë, që titullohet “Krismat e fundit”, fillon në faqen 144 dhe mbaron në faqen 148.

Kapitulli i gjashtëmbëdhjetë, që titullohet “I shitur në robëri”, fillon në faqen 148 dhe mbaron në faqen 151.

Kapitulli i shtatëmbëdhjetë, që titullohet “Perandoria e Faraonëve”, fillon në faqen 151 dhe mbaron në faqen 155.

Kapitulli i tetëmbëdhjetë, që titullohet “Vakancat e mia sovjetike”, fillon në faqen 156 dhe mbaron në faqen 158.

Kapitulli i nëntëmbëdhjetë, që titullohet “Mbretëria e punës së detyruar”, fillon në faqen 158 dhe mbaron në faqen 162, ku ka vetëm dy rreshta.

Kapitulli i njëzetë, që titullohet “Fitimtar dhe i mundur”, fillon në faqen 162 dhe mbaron në faqen 163.

Kapitulli i njëzetënjëtë, që titullohet “Rruga e kthimit te Vendi i Zanave”, fillon në faqen 164 dhe mbaron në faqen 165.

2. Emri

Nuk respektohet norma për trajtën e pashquar dhe trajtën e shquar të emrit. Për shembull kemi:

Përgjigja (46, 58), ishte *përgjigja* (77); por edhe *përgjigjeja e tyre* (64), *përgjegjeja (rasa emërore, 77)*, *pusho nja tri ditë nga shtëpia* (87); nëse kemi formën e normës në rasën gjinore: *por edhe e kësaj shfaqjeje të turpëshme* (111) nuk kemi formën e normës në rasën rrjedhore: *pas një zvarritje* (53), *pas një përleshje* (109), *çfarë mbrojtje reale* (112).

Për shumësin e emrit kemi oshilacion. Kështu për emrin **automobil**: *për automobilët englezë* (3), *dy automobilë (rasa kallëzore, 37)*, *morën dy automobilë* (38), *gjashtë automobilë* (131), *gjashtë automobilët (rasa kallëzore, 131)*; por kemi edhe *me një kolonë automobilash* (37), *kolona e automobilave* (38); për emrin **gjysmagjelë-gjysmagjela**: *gojët e gjysmagjelave* (143), *gjysmagjelat tanë* (144) por edhe: *gjysmagjelët* (144); këto **përgjegjësira** (47), *kam përgjegjësitë e mia* (47); *portat dhe dyert* (rasa kallëzore, 49) por edhe: *shqyen dyertë (rasa kallëzore, 49)*; u bënë **komandanta** (54), u bënë komandantë të kampeve të përqëndrimit (54).

Kemi një formë jo të normës të numrit shumës të emrit: *një nga heronjt e tij* (70); *mijt* (87), *të mijve* (90), *i kalon kufijt* (111); *Qën e bij qënsh!* (93), *Këta qën (rasa kallëzore, 93)*; *Janë kaptera* (113); *Komisarët e Batalionëve* (3), *me dy batalionë* (77), *e batalionëve të tjerë* (121), por kemi edhe formën e normës: *tre batalione (rasa kallëzore, 78)*. Japim një listë të shkurtër. Pas shembullit japim në kllapa numrin e faqes: *nga duartë* (6); *Në luftërat civile* (6), *Për të parë luftërat* (16), *Gjatë luftërave* (20); *tek miqt e tij* (40), *një nga miqt e mi* (95); *armiqt (kallëzore, 95)*; *U kthyen nëpër shtëpira* (38), *Shkoni në shtëpira* (116); *Me disa idera* (125); *punëra* (126); *e udhëheqsave f. 40*, *Udhëheqsa (kallëzore 46, 46)*; *Për mashtruesa* (126); *Nga kapelat e tyre* (95); *Prapa dyqanëve* (117), **dokumentat** (122, 123), *në dokumentat* (124), *dokumentat (kallëzore, 132)*, *me dokumentat e përgjakura* (124); *Pikpamjet* (30); *Qiejtë* (16) *për të arritur qiejtë* (29).

Shohim se forma jo e normës është e uniformuar dhe përdoret vetëm ajo në tekst: *Për pesëqind vjetë* (6), *pesëqind vjetë* (7), *tetë vjetë* (7), *katër vjetë* (14), *për katër vjetë* (135), *dy vjetë* (34), *tre vjetë* (44), *vjetë e vjetë* (35); *me yj* (17), *përmes yjve* (17), *me yjtë* (127). Japim vetëm disa shembuj të tjerë në vijim: *hieroglifët* (16), *matanë kaçubave* (17), *i ndaloj të dy kuajtë* (18); *përfaqses* (numri njëjës, emërore, 136), *dy përfaqsesit* (kallëzore, 136), *përfaqsesit* (emërore, 136, 137). Kemi forma të tjera jo të normës për shumësin: *djemt* (98, 98); *zotërinjt* (106); *në detra të paparë* (29).

Nganjëherë bie zanorja “ë” tek emri dhe kështu kemi një formë jo të normës: tek brryli (dhe jo bërryli f. 1); ose e kundërta ruhet zanorja “ë” në formën e shumësit dhe kemi një formë jo të normës: *me ëndërrat* (3), *një nga ëndërrat e tija* (11), *e ëndërrave të mia* (16), *të ëndërrave të mia të çuditëshme* (29).

Kemi një përdorim të një forme jo të normës të emrit me praninë e zanores “ë”: *në dimërin* (7), *një natë e çuditëshme dimëri* (31); *e kopështit* (21), *kopështet e vegjël* (14), *nga kopështet* (14), *kopështet* (14), *nëpër kopështe* (17).

Kemi përdorimin jo sipas normës të zanores “ë” edhe tek emri i përveçëm: *në Ballësh* (4).

Kemi përdorimin jo sipas normës të zanores “ë” tek emri në vend të zanores “e”: *në qëndër* (5, 21, 21), *dy qënie* (15), *qënia e vetme* (15), *për qënien* (24), *qënien* (24), *nga vëndi* (6), *vënd* (10), *një vënd* (12, 26), *në vëndin e caktuar* (18), *vdiq në vënd* (27), *në vëndin* (22, 30), *në vëndin e tij* (27), *në asnjë vënd* (29), *drejt vëndit* (29, 29, 29), *e vëndit* (36), *në vënde* (20), *në vëndet e mia* (30), *kjo gjëndje* (7), *nuk ishja në gjëndje* (25), *nuk jemi në gjëndje t’ua kthejmë* (26), *nuk jam në gjëndje* (34), *i ke mëndt* (11), *e mëndjes* (20), *i ishte mbushur mëndja* (26), *i mbaj mënd* (28), *në ndënjëset* (36).

Kemi forma jo të normës të emrit: *një djal* (20). Kemi një formë jo të normës në përdorimin e emrit të gjinisë femërore, numri njëjës, rasa gjinore, trajta e shquar: *e trimëris* (22). Kemi përdorimin e një forme jo të normës së emrit në trajtën e pashquar të rasës kallëzore: *më dhanë një kal* (3), *i një forme jo të normës së emrit në trajtën e shquar të rasës kallëzore: baban* (9) dhe jo babain ose babanë.

Kemi përdorimin e një forme të gegnishes: *zotnia i tij* (5, 2 herë), *zotnia* (6, 3 herë).

3. Folja

Fillojmë me foljet ndihmëse.

Kemi një formë jo të normës të foljes *kam* në vetën e parë, numri njëjës, koha e pakryer, mënyra dëftore: *kishja* (3, 31), *kishja mall për dikë* (3), *nuk kishja* (13, 18, 28).

Kemi si rrjedhim një formë jo të normës të foljes në kohën më se të kryer të mënyrës dëftore të vetës së parë të numrit njëjës: *kishja kaluar* (13, 29), *kishja marrë* (1), *kishja qëndruar* (1), *kishja shkruar* (31), *kishja vendosur* (2), *kishja zbuluar* (14), *kishja parë* (21), *kishja tërhequr* (3), *nuk kishja qënë* (3), *nuk kishja ardhur* (8), *nuk kishja lindur* (11).

Kemi oshilacion sepse kemi edhe formën e normës: *kisha ardhur* (3), *kisha dhënë* (3), *kisha kaluar* (14), *kisha krijuar* (29), *kisha mbetur* (4).

Kemi një formë jo të normës të foljes *kam* në kohën e pakryer, mënyra lidhore, veta e parë, numri njëjës: *të kishja një teatër* (28). Kemi një formë jo të normës të foljes ndihmëse *kam* në formën e mënyrës kushtore, koha e tashme, veta e parë, numri njëjës: *do të kishja rastin* (3).

Kemi një formë jo të normës të foljes në kohën e kryer të mënyrës dëftore, veta e dytë, numri shumës: *kini sharë* (13).

Kemi një formë jo të normës të foljes *jam* në vetën e parë, numri njëjës, koha e pakryer, mënyra dëftore: *ishja* (1), *Ishja* (4, 23), *ishja njëmbëdhjetë vjeç* (31), *Unë ishja* (3, 11, 11, 18, 18, 20, 24, 30, 36, 60), *Unë ishja një foshnjë djepi* (12), *Unë ishja shumë i kënaqur* (25), *Nuk ishja në gjëndje* (25, 59), *nuk ishja* (29, 29).

Kemi oshilacion sepse kemi edhe: *isha gati* (59), *isha duke e kaluar kohën time kot* (59).

Gjejmë të njëjtën formë jo të normës edhe në vetën e parë të kohës së pakryer të mënyrës lidhore: *doja të ishja* (19).

Gjejmë të njëjtën formë jo të normës edhe në vetën e parë të kohës së tashme të mënyrës kushtore: *unë do të ishja* (26).

Kemi një formë jo të normës të foljes në kohën më se të kryer të mënyrës dëftore, në vetën e parë, numri njëjës: *ishja dënuar* (29), *ishja shtruar* (1), *ishja ngarkuar* (3), *ishja pështjellë* (12), *ishja transferuar* (3), *ishja ngritur* (3), *nuk ishja shumë i përshtatshëm* (3).

Por kemi edhe oshilacion në përdorimin e formës. Kështu krahas formës jo të normës kemi edhe formën e normës: *nuk isha shëruar* (4).

Kemi një formë jo të normës për kohën e kryer të tejshkuar, veta e parë, numri njëjës, mënyra dëftore: *unë qesh rrëmbyer* (27).

Pjesorja e foljes ndihmëse *jam* del *qënë* dhe nuk na del forma e normës *qenë*. Kështu në formimin e formës së pashtjelluar përcjellore: *duke qënë* (15, 15, 15, 33).

Kemi një formë jo të normës për kohën e kryer, veta e tretë, numri njëjës, mënyra dëftore: *ka qënë* (29). Kemi forma jo të normës për kohën më se të kryer të mënyrës dëftore: *nuk kishja qënë* (3), *kishte qënë* (24, 44).

Tek Trebeshina gjejmë *u përgjegja*; kemi një formë jo të normës në mënyrën dëftore, në formën joveprore, numri njëjës të foljes *përgjigjem*: *u përgjegja* (113), *u përgjegj* (4, 45), *Ai m'u përgjegj* (35).

Kemi forma jo të normës të foljes në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore: *e pash tim vëlla* (53), *unë i lash* (115).

Kemi një formë jo të normës të foljes dal në mënyrën dëftore, koha e pakryer, veta e tretë, numri njëjës: *delte* (9, 17, 131).

E njëjta formë jo e normës del edhe në kohën e pakryer të mënyrës lidhore: *doja të delja* (129), *të delte* (54).

Kemi një formë jo të normës të foljes për mënyrën urdhërore, veta e dytë, numri njëjës, në përdorimin e saj me formën e trajtës së shkurtër të përemrit vetor, veta e tretë, numri njëjës, rasa dhanore: *thoji* (11, në vend të thuaji).

Kemi një formë jo të normës në përdorimin foljes së rregullt të zgjedhimit të parë në vetën e tretë, numri shumës, koha e pakryer, mënyra lidhore: *refuzuan të pagonin* (26).

Kemi një formë jo të normës në përdorimin e foljes së rregullt të zgjedhimit të parë në vetën e tretë, numri shumës, koha e tashme, mënyra lidhore: *nuk duan të pagojnë* (26).

Kemi një formë jo të normës të foljes në vetën e tretë, numri njëjës, mënyra lidhore: *duhet të tregoj* (35, dhe jo duhet të tregojë).

Kemi një formë jo të normës për mënyrën urdhërore, veta e dytë, numri njëjës të foljes së rregullt të zgjedhimit të dytë: *mos vra* (27).

Kemi një formë jo të normës të foljes *marr* në vetën e tretë, numri njëjës, koha e kryer e thjeshtë, forma joveprore: *u muar në konsideratë* (44), *Vinokashi u muar* (92).

4. Mbiemri

4.a. Në tekst kemi shumë forma të mbiemrit jo të normës. Ky fakt provon veçorinë e gjuhës së KT.

Kemi format e mbiemrit të nyjshëm që nuk i ka norma: *me punime të rënda të detyruarshme* (35), *një nxitim i pashpjeguarshëm* (3), *me një respekt të pashpjeguarshëm* (6), *të paevituarshme* (8), *i paimagjinuarshëm* (29), *e paimagjinuarshme* (24), *nuk ka hapësirë të mjaftuarshme* (14), *nën diellin e mrekulluarshëm* (17), *të mrekulluarshme* (17), *i mrekulluarshëm* (26), *në faqet e mrekulluarshme* (30), *në mënyrë të vazhduarshme* (17), *të vazhduarshme* (29).

Si edhe formën *shumë të paka*; norma ka: *i, e paktë* kurse KT përdor *i, e pakë*.

Kemi një formë jo të normës: *për automobilët englezë (3), automatikët englezë (3)*.

4.b. Përdorimi i zanores së patheksuar “ë” midis dy bashkëtingëlloreve tek mbiemri i nyjshëm dhe tek mbiemri i panyjshëm.

Kemi: një *gjumë i çuditshëm (20)*. Por: në atë luftë *të çuditëshme (3)*, në formën e *çuditëshme (11)*, me ndihmën e *çuditëshme (32)*, një ndjenjë e *çuditëshme (3, 15)*, një zhurmë të *çuditëshme (kallëzore, 37)*, e *çuditëshme (4, 15, 19, 22, 30, 31)*, qarja e *çuditëshme (5)*, ngjarja e *çuditëshme (23)*, një dritë e *çuditëshme (6)*, një lëvizje e *çuditëshme (14)*, të *çuditëshme (6, 16, 19)*, një gjë e *çuditëshme (7)*, një natë e *çuditëshme dimëri (31)*, dashuria e tij e *çuditëshme (11)*, influenza e tyre e *çuditëshme (11)*, më të *çuditëshme (16, 17)*, ndjenja të *çuditëshme dhe këngë të çuditëshme (27)*, të ëndërrave të mia të *çuditëshme (29)*.

Kemi edhe: vendimet *e bujëshme (30)*, *E habitëshme! (21)*, *Pa ndonjë shenjë të jashtëzakonëshme (6)*, e viteve të *mëparëshme (32)*, të *ndritëshme (30)*, një lumturi të *pamatëshme (16)*, pranë asaj gruaje të *papërkulëshme (15)*, përpjekjet e mia të *pasuksesëshme (30)*, tek Jeta e *përjetëshme (17)*, të *përjetëshme (24)*, këngën e *përvajëshme (17)*, me fjalë të *përgjithëshme (6)*, gjëra të *përbindëshme (21)*, shënimet e *shkurtëra (30)*, një ndjenjë e *tmerrëshme antipatije (11)*, një asgjë e *tmerrëshme (14)*, një gjë të *tmerrëshme (21, 29)*, e *tmerrëshme (24)*, të *tmerrëshme (24)*, me mjegullitë e *misterëshme (13)*, me Zonjën e *Mëshirëshme (14)*, nga Zonja e *Mëshirëshme (14)*, e Zonjës së *Mëshirëshme (25)*, me ato krijesa të varfëra (21), të luftës shqipëtare (3), ata u aklimatizuan me jetën shqipëtare (6), të lëvizjes Shqipëtare (25), Lëvizjes komuniste shqipëtare (34), një grua shumë të rrebtë shqipëtare (26), komunistët shqipëtarë (34), e komunistëve shqipëtarë (33), e komunizmit shqipëtar (33).

Por kemi oshilacion sepse kemi edhe: vajza shqiptare (7).

4.c. Kemi forma jo të normës: *gjellët e pregatitura (9)*; kemi përdorimin e formës jo të normës me zanoren “ë”, në vend të zanores “e”: *pasqyrën e argjëndtë (17)*, *mëndjemadhe (9)*, në *vorbullën marramëndëse (25)*, të *Punëve të Brëndëshme (34)*, *përmes resh të zeza të dëndura (16)*, të *shtrëmbëruar (9)*.

Kemi forma jo të normës: *i zëmruar (11)*, *ai është i sigurtë (11)*, *i sigurtë (29)*, *të jeni të sigurtë (30)*; në *moshën dy vjeçare (12)*.

4.d. Kemi përdorimin e gjinisë mashkullore të mbiemrit në vend të gjinisë femërore: *dhe pyjet të shpërndarë (13)*, *kopështet e vegjël (14)*,

përmëndëm subjekte nga më të ndryshmit (144), të njëjtët horizonte (145), monopetet e maleve ishin të lodhshëm (2), vargjet e vërtetë (31). Kemi edhe përdorimin e mbiemrit në gjininë femërore të numrit shumës në kundërshtim me normën: *e librave më të rëndësishme* (30), *përmes ujrash të paana* (16), *të ujrave të qeta* (17).

Kemi një formë jo të normës të mbiemrit të nyjshëm në numrin shumës, gjinia femërore: *prekën pastrimet e mëdhaja* (44), *patëm ndryshime të mëdhaja* (48).

5. Përemri

Edhe në përdorimin e përemrit kemi mosrespektimin e normës. Kështu kemi formën e rasës kallëzore të përemrit vetor të vetës së tretë, numri njëjës me parafjalët *në*, *me*, *për*, *mbi* dhe me apostrof: *në 'të* (4, 29, 34, 36), *me 'ta* (4, 15), *tregoja për 'të* (23), *për 'të* (26), *mbi 'të* (35).

Kemi përdorimin e një forme jo të normës të trajtës së shkurtër të bashkuar të përemrit vetor: *nuk jemi në gjëndje t'ua kthejmë* (26, në vend të *t'jua kthejmë*), *Për çfarë po u tregoj?! (30, forma e normës është ju).*

Kemi një formë jo të normës të përemrit pronor, rasa dhanore: *ia la t'im eti* (11), *i tregova t'im eti* (20), rasa gjinore: *qëndrimi i t'im eti karshi meje* (11), *rasa rrjedhore: pranë t'im eti* (18).

Për përemrin pronor kemi forma jo të normës: *një miku i ynë* (3), *një kushëri i ynë* (21), *shërbetori i ynë* (23); *Tezja e ime* (4, 8, 10), *Ardhja e ime* (5), *Nëna e ime* (9, 9, 10, 10, 10, 11, 15, 18), *Halla e ime* (9, 9), *familja e ime* (9), *fëmijëria e ime* (15), *Gjyshja e ime* (14), *ditëlindja e ime* (17), *aventura e ime* (21), *jeta e ime* (25, 29, 30); *gjyshi i im* (6, 7, 8, 10, 11, 11); *babai i im* (7, 7, 8, 10, 10, 19, 25); *Babai i im* (11, 11, 13); *vëllai i im* (7, 12, 36, 37), *kumtri i im* (9); *burri i im* (23), *dështimi i im* (36), *miku i im* (19); *Zoti i im* (25, 30); *viti i im* (21); *karrocieri i im* (21); *familja e jonë* (7), *shërbetorja e jonë* (9), *bota e jonë* (14, 14, 14), *dashuria e jonë* (14), *me gërmat e tija* (17), *me shpenzimet e tija* (7), *kontradiktat e tija* (8), *për të dyja vajzat e tija* (10), *një nga ëndërrat e tija* (11), *të dimëronte dhëntë e tija* (18), *në duart e tija* (21), *të prekja armët e tija* (25), *me Valkiriet e tija* (29); *dimensionet e saja* (14), *në duart e saja* (13), *nga fjalët e saja* (10), *në vendimet e saja* (10), *nën përkujdesjet e saja* (15), *propozimet e saja* (10, kallëzore), *nuk ia falën Hallës sharjet e saja* (12), *me dredhitë e saja* (12), *me shkollat e saja* (33), *vajzat e saja* (13).

Kemi oshilacion në përdorimin e një forme jo të normës së përemrit pronor në rasën gjinore: *i nënës time* (3), *e nënës time* (6), *të nënës time* (7); por kemi *para dëshirës sime* (3), pra formën e duhur të përemrit

pronor në rasën rrjedhore, por kemi edhe formën e normës të rasës gjinore: *me urdhër të nënës sime* (8), *e nënës sime* (9, 9, 9, 10).

6. Fjalët e huaja

Përveç afrisë që ka me toskërishten dhe me gjuhën e folur KT përdor edhe fjalë të huaja, sidomos italianizma. Kjo rrjedh nga njohja e italishtes prej KT dhe nga prania e referimeve italiane në tekst. Kemi folje, emra dhe mbiemra. Kemi foljet: *Atë verë aderova në Grupin Komunist të Shkodrës* (39), *Ata u aklimatizuan me jetën shqipëtare* (6), *Ata insistuan* (21), *tentuan* (50). Emrat: *komplikacionet* (rasa kallëzore, 54), *një kapriçio* (125), *nga kjo koinçidencë e çuditëshme* (47), *retë e konfuzionit* (39), *për kualitetin e atij mjalti* (101, 101), *sublimitet* (23), *një tolerancë* (39), *e këtij korenti* (33), *korente komuniste* (39). Por kemi oshilacion sepse në f. 34 kemi: *përveç këtyre dy rrymave; prorektor* (48).

Mbiemrat: *kavaleresk* (27), *udhëheqsa fanfaronë* (38), *për akte diversive* (68), *me krime monstruoze* (46).

Nuk kemi uniformitet në shkrimin e fjalëve të huaja. Ruajnë formën e gjuhës së prejardhjes: *e fitova roundin e parë* (62), *isha një d'Artagnan i ri* (61). Por kemi: *Johan Shtrausi* (66).

Në një rast kemi përdorimin e fjalës së huaj në thonjza: *të "secesionit"* (116).

7. Shkronja e madhe

Në tekstin e KT kemi një përdorim të shkronjës së madhe edhe kur nuk parashikohet nga norma: për emrat e ditëve të javës, për emrat e muajve të vitit, për emrat e fafëfisnisë, për emrat që tregojnë kombësinë, për pikat e horizontit. Edhe kjo është një karakteristikë e shkrimit të KT dhe e dallon atë nga pjesa tjetër e prozës moderne dhe bashkëkohore shqiptare.

Ja vetëm një pjesë e shembujve për ditët e javës: *e Martë* (14), *dita e Martë* (14, 14).

Për muajt e vitit kemi shkronjën e madhe tek emri i muajit kur jepet data, por edhe kur nuk jepet data: *Më datën 5 Jenar 1942* (48), *Më 7 Jenar 1942* (48), *më 18 Prill 1944* (2), *më 3 Maj 1944* (2), *më 5 maj 1942* (53), *më 17 Maj 1942* (52), *gjer më 6 Prill 1942* (50), *më 16 Prill 1944* (2), *më tre Prill 1939* (35), *më shtatë Prill* (37), *më 3 Qershor 1942* (52), *kaloi Qershori* (53), *më 6 Qershor 1942* (52), *e 28 Gushtit 1926* (5), *më 17 Shkurt* (7), *më 20 Shkurt* (7), *Më 8 Gusht* (7), *Muaji i Majit* (21), *Në Korrik të 1939-ës*, *Në Shtator* (34), [*Por edhe kur kemi emrin e muajit të ndjekur afër nga emri i stinës së vitit: Në Nëntor të asaj Vjeshte* (43)], *në Jenar* (7), *më 1 Jenar* (7), *një Jenari* (32), *një ditë të bukur Jenari* (32).

Ja disa shembuj për emrat e farefisnisë me shkronjë të madhe: *dhe Babai i im (11, 13), dhe Babai (11), Babai i im (11), Babait tim (11), Dajua (38), e Gjyshit tim (9), emrin e Gjyshit tim (11), Gjyshi (10, 11), Gjyshi i im (11), Babai dhe Gjyshi i im (11), fantazma e Gjyshit (11), Gjyshja (14, 14), e Gjyshes (14), së Gjyshes (15), Gjyshja e ime (14), Tezja (10, 12, 15), Tezja e ime (10), me Tezen time (11), Tezen (15), nëna me Tezen (25), dhe Tezja (26), e Hallës (10), Halla (10, 12), nuk ia falën Hallës sharjet e saja (12), Nëna e ime (11), por Nëna (26).*

Kemi një oshilacion: *vëllai i im (12)*: këtu vëllai shkruhet me shkronjë të vogël.

Kemi përdorimin e shkronjës së madhe për të treguar përkatësinë kombëtare dhe shtetërore: *fshinte Gjermanët (25), Gjermanëve (67), të Gjermanëve (70), i ndihmonte Gjermanët (69), nga Grekët (65), nga Italianët (65). Por edhe për mbiemrin: Komandanti Gjerman (68), nga invazionet Mongoliane (147).*

Dhe një shembull për pikat e horizontit: *Në Veri të Shkumbinit (44).*

8. Ndryshime fonetike.

a) kemi zanoren y në vend të zanosës i: *fyshekun (3), një fyshek (27), fyshekë (19, 19).*

b) kemi bashkëtingëlloren mbylltore dybuzore të zëshme b në vend të dybuzores së pazëshme p: *Një grua shumë të rrebtë shqipëtare (26), shumë i rrebtë (95).*

Por kemi oshilacion: *me rreptësi (98).*

c) në vend të bashkëtingëllores dridhëse qiellzore-alveolare rr gjejmë bashkëtingëlloren dridhëse alveolare r dhe anasjelltas. Përdorimi është uniform në fjalët me të njëjtën rrënjë: *për karrierën (26), e këtij korenti (33); gërrmuesi (35), kishin gërrmuar (44), me mjekërr (19, 31), qeverria (34, 43), qeverria fashiste (44), të qeverrisë (20), i qeverrisjes (104), qeverrisja (38), pakëz bukë thekrre (97), vallen e furrishme (16), bombe të kurrdisur (20), po kurrdiste (44), filloi të bërrtiste (48, 48), të grrisur (38).*

d) kemi bashkëtingëlloren fërkimore alveolare të pazëshme s në vend të bashkëtingëllores fërkimore qiellzore-alveolare të pazëshme sh: *Një nga Bosnjakët më të zottë (9), nga Bosnjaku i shkathët (10), bosnjak (12, mbiemër), bosnjaku (12, emër).*

e) kemi bashkëtingëlloren fërkimore alveolare të zëshme z në vend të bashkëtingëllores fërkimore alveolare të pazëshme s: *mëngjezin tjetër (2), në mëngjez (3, 29, 31, 36), ai mëngjez (32), me një autobus (20), mezi i natës (37).*

f) në vend të bashkëtingëllores mbylltore dhëmbore të pazëshme t kemi bashkëtingëlloren dhëmbore të pazëshme th: *veprime arithmetike* (25, *rasa kallëzore*), *unë ishja shumë entuziast* (57), *i entuziasmuar* (103), *entuziazmi* (44, 51). Kemi oshilacion: *asnjë entuziazëm* (55); *theatrit* (28), *Çfarë skene madhështore teatrale* (86), *simpathizonte* (30), *simpathizonim* (49), *simpathinë* (34, 46, 95), *simpathizantësh* (56).

9. Sintaksa

Përsa i përket mosrespektimit të rregullave të sintaksës për ndërtimin e fjalisë dhe të periudhës vërejmë se nuk kemi përputhjen midis kohës së foljes të të dy pjesëve të kallëzuesit të përbërë foljor. Kështu në vend të kohës së pakryer të mënyrës lidhore kemi kohën e tashme të mënyrës lidhore:

1. *Sa fillova të ngjis të përpjetën e Drenovës, për çudinë time të madhe, takova vëllanë.* (60)
2. *Duke qënë gjallë, fillova të mendoj për ata që nuk ishin vranë akoma.* (148)
3. *Në atë kohë u ktheva përsëri në mënyrë të drojtur nga letërsia dhe fillova të mendoj edhe për pikturën.* (149)
4. *Në heshtje u ktheva tek përpjekjet letrare të fëmijërisë sime dhe fillova të mendoj edhe për pikturën.* (151)
5. *Kjo tregon se akoma e kisha iluzionin ndaj “udhëheqësve të mirë komunistë”, megjithëse kisha filluar ta kuptoj se më 1938 kisha qënë më i mënçëm.* (160)

Nuk kemi përputhjen në kohën e foljes dhe në fjalinë e varur kundrinore:

1. *Duke qënë një european i vendosur, e ndava mëndjen që ta ndërpres monologun e tij dhe thashë:...* (153)
2. *Nuk e di çfarë thanë pasi dola unë jashtë, por është logjike që krerët e Institutit të kenë informuar menjëherë Organizatën Shqiptare të Studentëve të Leningradit dhe, pa humbur kohë, rusët dhe shqiptarët, vendosën të thërresin një mbledhje të përgjithëshme / për të më përjashtuar nga Instituti dhe nga partia.* (154/155)
3. *Nuk e di çfarë më bëri që ta lë spitalin!...* (2)
4. *Në Maj të 1945-ës, prindërit e mi dhe veçanërisht nëna e ime më detyruan që të fejohej me një vajzë me të cilën shumë shpejt u martova.* (149)

10. Çdo ndryshim nga norma që hasim në tekst na bën të kuptojmë edhe më mirë idiosinkrasinë e Kasëm Trebeshinës. Nëse kjo gjë është e njohur për kredon letrare të autorit dhe qëndrimin e tij ndaj veprës së vet

dhe ndaj letrave shqipe, ky punim ka si qëllim të vërë në dukje këtë edhe në lidhje me gjuhën e autorit. Përveç kësaj mundësia që kam pasur për të lexuar veprën (dhe pastaj për ta përkthyer në italishte) në një kopje të pabotuar më krijon bazën për një studim të varianteve të autorit në rastin e një botimi të veprës. Paraqitja dhe analiza e dallimeve gjuhësore nga norma të këtij teksti është një provë tjetër e nevojës së botimeve kritike edhe të veprave të autorëve të letërsisë sonë moderne dhe bashkëkohore.

